



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

---

## Raporti vjetor

Oda e Mjekëve të Kosovës



Dhjetor 2018


## Prishtinë

**Përmbajtja:**

Raporti vjetor .....	1
1. Anëtarësimi .....	3
2. Bartja e kompetencave .....	4
2.1 Mbikëqyrja etiko-profesionale .....	4
2.2 Edukimi i Vazhdueshëm Profesional .....	5
2.3 Licencime .....	5
2.4 Edukimi specialistik - bartja e kompetencës .....	6
3. Raporti financiar .....	6
3.1 Gjendja financiare 1 janar 2018 - 31 dhjetor 2018 .....	6
3.2 Fondi i Solidaritetit .....	7
4. Funkcionalizimi i OMK-së .....	7
4.1 Infrastruktura juridike .....	7
4.2 Shërbimi profesional .....	8
4.3 Renovimi i objektit për shfrytëzimin nga OMK-ja .....	8
5. Aktivitete të tjera .....	8
5.1 Faksimilet (Vulat) .....	8
5.2 Ueb-faqe <a href="http://www.omk-rks.org">www.omk-rks.org</a> .....	9
5.3 Sondazhe dhe hulumtime .....	9
5.4 Organizime dhe bashkorganizime .....	10
5.5 Pjesëmarrja në komisione .....	11
5.6 Bashkëpunimi me OSBE-në .....	11
6. Bashkëpunim ndërkombëtar .....	12
6.1 Anëtarësimi në Komitetin e Përhershëm për Mjekët e Evropës (CPME) .....	12
6.2 Takime të tjera ndërkombëtare/rajonale .....	12
Plan veprimi për 2019 .....	12
7.1 Projekte afatgjate .....	12
7.2 Aktivitetet kyç për 2019 .....	13

## 1. Anëtarësimi

- Anëtarësimi në Odën e Mjekëve të Kosovës ka filluar më datë 30 janar 2018 dhe deri në fund të dhjetorit 2018 në OMK janë anëtarësuar 3 681 mjekë. Në Kuvendin e datës 5 mars 2018, me të cilin është ndryshuar Vendimi i Kuvendit nga janari i vitit 2018, është përcaktuar kuota e anëtarësisë në shumë prej 0.8% të pagës neto për të gjithë mjekët e punësuar në sektorin publik dhe në atë privat, ndërsa për mjekët shtetas jokosovarë, që janë të angazhuar në sektorin privat, 250.00 € për vit kalendarik.
- OMK-ja ka krijuar Regjistrin e parë të konsoliduar të mjekëve, ku të dhënat përditësohen në baza të rregullta.




- Në këtë periudhë OMK-ja ka bërë edhe printimin dhe shpërndarjen e kartelave të anëtarësisë të cilat, përveç tjerash, do të synojnë të bëjnë të mundur edhe regjistrimin dhe evidentimin automatik të vijimit të anëtarëve tanë në ngjarjet e EVP-së, falë pajisjeve përcjellëse elektronike.

## 2. Bartja e kompetencave

### 2.1 Mbikëqyrja etiko-profesionale


- Vendimi i datës 22 shkurt 2018, për bartjen e kompetencave nga Bordi Qendror Etik i MSH-së tek Këshilli Etiko-Profesional i OMK-së, ka shënuar edhe funksionalizimin e këtij organi të OMK-së.
- Duke filluar nga kjo datë, Këshilli Etiko-Profesional ka pranuar 21 lëndë, ku ka marrë vendime për 10 sosh, 7 lëndë të tjera janë përcjellë tek prokurori i OMK-së, 2 lëndë janë në procedurë, kurse dy lëndë kanë qenë me afat të parashkruar.
- Gjyqi i Nderit ka marrë vendim për një lëndë



- **Sfidat apo vështirësitë**, të cilat e kanë përcjellë Këshillin Etik të OMK-së që nga fillimi i punës, në shkurt 2018 deri më tani, kanë qenë të natyrës së shqyrtimit të lëndëve, ku për objekt trajtimi ka qenë shkelja profesionale e profesionistëve shëndetësorë, dhe, si rrjedhojë e kësaj sfide, Këshilli Etik ka propozuar që të hartohen dy rregullore, si në vijim:
  - Rregullore mbi kategorizimin e shkeljeve profesionale për dallim nga ato etike që janë të përcaktuara me Kodin Etik, dhe
  - Rregullore mbi format dhe procedurat e angazhimit të ekspertëve për vlerësim profesional: trajnimi, certifikimi, format e kompensimit dhe të sanksionimit.


## 2.2 Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

- Më datën 26.4.2018 është bërë bartja formale e kompetencës së Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, Licencimit dhe Rilicencimit tek organet kompetente të OMK-së.
- Duke filluar nga kjo datë OMK-ja ka akredituar 89 aktivitete dhe ka ofruar përkrahje për 7 aktivitete dhe 7 individë



## 2.3 Licencime

- Duke filluar nga data 26 prill 2018, Komisioni për Licencim dhe Rilicencim ka lëshuar 563 licenca me kategoritë si në grafikonin më poshtë:



## 2.4 Edukimi specialistik - bartja e kompetencës

- Dizajnimi dhe fillimi i fazës transitore të bartjes së kompetencave të edukimit specialistik (zberthimi ligjor, financiar dhe teknik) është në proces e sipër

## 3. Raporti financiar

### 3.1 Gjendja financiare 1 janar 2018 - 31 dhjetor 2018

1.0 Të hyrat:	TM1	TM2	TM3	TM4	Realizimi: TM1:TM4
1.1 Të hyrat nga anëtarësia:					
1.1.1 Anëtarësimi i mjekëve qytetarë kosovarë	€ 42.727.04	€ 54.272.94	€ 56.181.60	€ 60.084.60	€ 213.266.18
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve qytetarë jokosovarë	€ 3.500.00	€ -	€ 1.500.00	€ 1.500.00	€ 6.500.00
1.2 Licencimi	€ 3.740.00	€ 12.511.00	€ 14.360.00	€ 11.128.14	€ 41.739.14
1.3 Të hyrat e tjera	€ 651.00	€ 3.911.00	€ 4.925.54	€ 4.475.00	€ 13.962.54
<b>TOTAL TË HYRAT</b>	<b>€ 50.618.04</b>	<b>€ 70.694.94</b>	<b>€ 76.967.14</b>	<b>€ 77.187.74</b>	<b>€ 275.467.86</b>

2.0 SHPENZIMET	TM1	TM2	TM3	TM4	Shpenzimet: TM1:TM4
2.1 Paga dhe kontributet pensionale	€ 7.717.50	€ 12.160.29	€ 12.188.28	€ 13.873.22	€ 45.939.29
2.2 Mëditjet	€ 238.20	€ 28.863.37	€ 13.363.90	€ 9.863.83	€ 52.329.30
2.3 Material shpenzues	€ 394.55	€ 1.569.62	€ 689.48	€ 1.810.93	€ 4.464.58
2.4 Reprerentacioni	€ -	€ 106.60	€ 234.40	€ 405.26	€ 746.26
2.5 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€ -	€ 362.80	€ 6.457.50	€ 4.170.94	€ 10.991.24
2.6 Shpenzimet e tjera	€ 290.07	€ 852.75	€ 1.534.93	€ 12.207.94	€ 14.885.69
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€ -		€ 1.000.00	€ 2.000.00	€ 3.000.00
<b>TOTAL SHPENZIMET</b>	<b>€ 8.640.32</b>	<b>€ 43.915.43</b>	<b>€ 35.468.49</b>	<b>€ 44.332.12</b>	<b>€ 132.356.36</b>

**Bilanci**

**€ 143.111.50**

**Sfidat:**

- Mangësi në procedimin e listave në tërësi nga Departamenti i Pagesave në MF;
- Deklarimi joreal i të ardhurave nga mjekët e sektorit privat, pjesa që paguajnë 0.8% e rrogës neto;
- Ikja nga anëtarësimi e një numri të konsiderueshëm të mjekëve të huaj.

**3.2 Fondi i Solidaritetit**

- Sipas vendimit të Kuvendit të OMK-së, 3.1% e buxhetit total mujor bartet në xhirollogarinë e Fondit për Solidaritet;
- Komisioni për Solidaritet dhe Ndhimë Reciproke ka pranuar gjithsej 4 kërkesa për përkrahje financiare;
- 2 (dy) nga këto kërkesa janë përkrahur;
- 2 (dy) janë refuzuar.

**4. Funksionalizimi i OMK-së****4.1 Infrastruktura juridike**

- Kuvendi i OMK-së ka mbajtur mbledhjen e rregullt më 19 qershor 2018, në të cilën janë miratuar një sërë aktesh normative:
  - Rregullorja për Regjistrimin, Licencimin dhe Rilicencimin e Mjekëve;
  - Rregullorja për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
  - Rregullorja për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së;
  - Rregullorja për Përcaktimin e Llojeve të Shkeljeve Etike dhe Procedurat e Mbikëqyrjes Etike;
  - Rregullorja për Menaxhimin e Financave të OMK-së;
  - Rregullorja për Punën e Komisionit për Solidaritet dhe Ndhimë Reciproke; dhe
  - Rregullorja për Fushëveprimin dhe Kompetencat e Komisionit për Çështje Etike.
- OMK-ja ka ndërmarrë dhe ka hartuar draftet e para të dy iniciativave ligjore, ku kemi marrë edhe mbështetjen e ministrit të Shëndetësisë, z. Ismajli, ministrit të Drejtësisë, z. Tahiri dhe anëtarëve të Komisionit

Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Këto dy iniciativa janë:

1. Ligji mbi të drejtat dhe obligimet e mjekut;
2. Udhëzimi administrativ mbi rregullimin e çështjes së ekspertizave gjyqësore në lëmin e mjekësisë.

#### **4.2 Shërbimi profesional**

- Pas aprovimit të organogramit nga Këshilli Drejtues janë rekrutuar me kontratë të rregullt 4 zyrtarë (administrativë, ligjorë dhe financiarë);
- Këtu shtohen edhe 4 zyrtarë, ekspertë të jashtëm të alokuar nga Lux Dev: ekspert ligjor, ekspert administrativo-organizativ, ekspert i IT-së dhe databazës dhe ekspert i jashtëm për çështje ligjore/organizative;
- Po ashtu, duhet të shtohet se pas aprovimit nga Këshilli Drejtues, në periudha kohore tremujore janë angazhuar edhe tre studentë.

#### **4.3 Renovimi i objektit për shfrytëzimin nga OMK-ja**

- Me mbështetje të Projektit KSV/01, projekt bashkëpunimi mes Qeverisë së Luksemburgut dhe të Republikës së Kosovës, programi përkrahës për shëndetësi, është bërë renovimi i objektit për shfrytëzimin e Odës së Mjekëve.
- Me këtë rast është nënshkruar marrëveshja mes OMK-së dhe Ministrisë së Drejtësisë/Institutit të Mjekësisë Ligjore, për shfrytëzimin e ish hapësirave të Institutit.

### **5. Aktivitete të tjera**

#### **5.1 Faksimilet (Vulat)**

- Oda e Mjekëve gjatë muajit gusht ka shpallur ftesën publike për ofertë për punimin/prodhimin e autorizuar të faksimileve sipas formës së miratuar dhe përmbajtjes që është përcaktuar me nenin 21, paragrafin 4, të Rregullores për Regjistrimin, Licencimin dhe Rilicencimin e Mjekëve.
- Prandaj, të gjithë mjekët që ofrojnë shërbime shëndetësore dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, nga data 1 janar 2019 do të jenë të obliguar që të pajisen me faksimilet unike të prodhuara nën autoritetin e OMK-së.



- Shpërndarja e faksimileve tanimë ka filluar dhe deri tani faksimilet janë dorëzuar te përfaqësuesit e OMK-së në rajonet e Pejës, Prishtinës, Podujevës, Prizrenit dhe në disa spitale private.
- Afati i shpërndarjes së faksimileve është 1 shkurt 2019, me mundësi të shtyrjes nga Këshilli Drejtues.

## 5.2 Ueb-faqe [www.omk-rks.org](http://www.omk-rks.org)

- Më 26 prill 2018, gjatë ceremonisë së bartjes së kompetencave për Licencim dhe EVP, është bërë edhe lansimi i ueb-faqes së OMK-së.
- Nga kjo datë e deri tani në këtë ueb-faqe janë publikuar të gjitha lajmet dhe rregulloret në fuqi të OMK-së dhe informata të tjera relevante të përditësuara në baza të rregullta.

## 5.3 Sondazhe dhe hulumtime

### 5.5.1 Sondazhi – dhuna ndaj mjekut

- Oda e Mjekëve të Kosovës ka zbatuar anketën mbi dhunën ndaj mjekut në periudhën nga 11 maj deri më 21 maj 2018.
- Në këtë anketë morën pjesë mjekët nga të gjitha nivelet shëndetësore në Kosovë.
- Metoda e anketimit ka qenë online, ku pyetësi është dërguar përmes linkut me email tek të gjithë anëtarët e OMK-së. Përgjigje në pyetësin e parashtruar kanë dërguar 381 anëtarë të OMK-së (12.09% nga totali i mjekëve të anëtarësuar), prej tyre 61.80% ishin të gjinisë mashkullore dhe 38.20% të gjinisë femërore.
- Rezultatet e këtij sondazhi janë publikuar në ueb-faqen e OMK-së.

### 5.5.2 Sondazhi - sigurime profesionale

- Gjatë javës së fundit të muajit shtator OMK-ja ka lansuar një sondazh brenda anëtarësisë lidhur me sigurime profesionale, ku morën pjesë 827 mjekë.
- Oda e Mjekëve të Kosovës përmes këtij hulumtimi ka për qëllim që të analizojë indikatorët e brendshëm nga anëtarët e saj (mjekët) në kuptim të zbatimit të një sistemi të tillë të sigurimeve.
- Rezultatet e këtij sondazhi janë publikuar në ueb-faqen e OMK-së.

### 5.5.3 Hulumtimi - kujdesi dhe qasja e mjekut ndaj pacientit

- Në bashkëpunim me Organizatën e Studentëve të Mjekësisë – KOMS, OMK-ja ka zbatuar hulumtimin “Kujdesi dhe qasja e mjekut ndaj pacientit”.
- Objektivat kryesore të këtij hulumtimi janë:
  - Matja dhe njohja e nivelit të kënaqshmërisë së pacientëve lidhur me ofrimin e shërbimeve mjekësore;
  - Identifikimi i shkaqeve të pakënaqësisë së pacientëve me shërbimet shëndetësore të pranuara;
  - Matja e nivelit të njohurive të popullatës lidhur me kompetencat publike dhe rolin e Odës së Mjekëve të Kosovës.
- Publikimi i gjetjeve nga ky hulumtim është bërë gjatë konferencës për media për raportimin vjetor të punës së OMK-së, më 26 dhjetor.
- Rezultatet e këtij sondazhi janë publikuar në ueb-faqen e OMK-së.

### 5.5.4 Pyetësori – Fondi i Solidaritetit

- Përmes pyetësorit OMK-ja ka propozuar rritjen e buxhetit të Fondit të Solidaritetit me dhënien e një euroje ( 1 euro) nga të gjithë anëtarët në baza mujore, dhe në këtë mënyrë të ndihmohen sa më shumë raste që parashtrojnë kërkesën në OMK.
- Rezultatet e këtij pyetësori do të shpalosen në Kuvendin e OMnK-së, që planifikohet të mbahet në javën e parë të muajit janar 2019.

## 5.4 Organizime dhe bashkorganizime

### 5.4.1 Bashkorganizimi i Konferencës së Bioetikës

- Më 19 tetor 2018, nën patronazhin e Odës së Mjekëve të Kosovës dhe në bashkorganizim me njësitë e Bioetikës të Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, në kuadër të UNESCO-s, është organizuar Konferenca e Tretë Ndërkombëtare e Bioetikës me temën: “Solidariteti dhe bashkëpunimi”.

#### **5.4.2 Organizimi i tryezës së rrumbullakët "Përgjegjësia profesionale, etike dhe penale e mjekut- kufijtë dhe sfidat"**

- Më 14 maj 2018, Oda e Mjekëve ka organizuar tryezën e rrumbullakët me temën “ Përgjegjësia profesionale, etike dhe penale e mjekut - kufijtë dhe sfidat.
- Në këtë tryezë të rrumbullakët morën pjesë ministri i Shëndetësisë, ministri i Drejtësisë, sekretarja e përgjithshme e Komitetit të Përhershëm të Mjekëve Evropianë, përfaqësues nga odat e rajonit dhe përfaqësues të tjerë relevantë nga Kosova.
- Sipas gjetjeve nga kjo tryezë, OMK-ja ka hartuar Udhëzimin administrativ mbi rregullimin e çështjes së ekspertizave gjyqësore në lëmin e mjekësisë.

#### **5.4.3 Organizimi i tryezës së rrumbullakët "Plan veprimi i Odës së Mjekëve"**

- Me qëllim të avancimit të rregullimit të brendshëm normativ, OMK-ja ka mbajtur një tryezë të rrumbullakët me temën “Plan veprimi i Odës së Mjekëve”.
- Në këtë tryezë janë diskutuar nevojat e modifikimit të akteve normative (përfshirë këtu Statutin e Odës, Kodin Etik dhe akte të tjera normative) dhe plan veprimi për vitin 2019.
- Ndryshimet do të shqyrtohen në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të OMK-së, që planifikohet të mbahet në javën e parë të muajit janar 2019.

### **5.5 Pjesëmarrja në komisione**

- Ligji për Shëndetësi
- Ligji i Pagave
- Strategjia sektoriale për resurse njerëzore.

### **5.6 Bashkëpunimi me OSBE-në**

- Më 30 nëntor 2018, Zyra e OSBE-së në Prishtinë ka organizuar tryezën e rrumbullakët për organet e OMK-së, konkretisht për organet të cilat merren me çështjet etiko-profesionale në shëndetësi.
- Qëllimi i kësaj tryeze ishte identifikimi i problemeve dhe sfidave të organeve të OMK-së, përkatësisht Prokurorit të Odës, Këshillit Etik,

Gjyqit të Nderit dhe Komisionit për Çështje Etike, si dhe mundësia e organizimit të trajnimeve të ofruara nga OSBE-ja në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë së Kosovës dhe institucionet e tjera të drejtësisë në Kosovë, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të këtyre organeve për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre në organet gjegjëse.

## **6. Bashkëpunim ndërkombëtar**

### **6.1 Anëtarësimi në Komitetin e Përhershëm për Mjekët e Evropës (CPME)**

Më 10 nëntor 2018, Asambleja e Përgjithshme e Komitetit të Përhershëm të Mjekëve Evropianë ka miratuar anëtarësimin e Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës, si anëtare vëzhguese me status të barabartë me të gjitha shtetet që nuk janë anëtare të BE-së.

### **6.2 Takime të tjera ndërkombëtare/rajonale**

- OMK-ja ka vazhduar aktivitete koordinuese në kuadër të ZEVA-s;
- OMK-ja ka marrë pjesë në takime bashkëpunuese organizuar nga Oda e Malit Zi dhe Shqipëria;
- OMK-ja është përfaqësuar në Kongresin e Odës së Gjermanisë.

## ***Plan veprimi për 2019***

### **7.1 Projekte afatgjate**

- OMK-ja ka iniciuar projektin e ndërtimit të një objekti për të gjitha OPSH-të mbështetur nga MSH-ja, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja në sektorin e shëndetësisë”. Kësaj iniciative i janë përgjigjur të gjitha OPSH-të dhe një kërkesë zyrtare për mbështetje është nënshkruar nga të gjitha ato, kurse më 23 tetor është dorëzuar në MSH.
- Krijimi i sistemit informativ/databazë interaktive, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohëzgjatja e projektit – 1 vit (Lux Dev)
- Krijimi i arkivit digjital.

## **7.2 Aktivitetet kyç për 2019**

- Sigurime profesionale;
- Bartja e kompetencës për edukimin specialistik;
- Tri (3) konferenca/kongrese ndërkombëtare në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Telemjekësisë së Kosovës;
- Auditimi financiar dhe funksional;
- Konkursi për përkrahje të pesë (5) punimeve shkencore.